



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR BUJQËSI , PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Reference: 12-320

Datë:	13.07.2017
Për:	z.Imri AHMETI - Kryetar i Komunës së Lipjanit
Nga:	Feti KRASNIQI -Drejtore i Drejtoratit për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural
Lënda:	Raporti mujor i punës për muajin Qershor : 2017

Shtojcë: Raporti i aktiviteteve të Drejtoratit për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural për muajin Qershor : 2017

DBPZHR ne Lipjan gjatë muajit Qershor 2017 , ka zhvilluar këto aktivitete :

Aktivitete profesionale :

- Takimet javore në Bordin e Drejtorëve
- Në një konsultim të përbashkët me 3 partnerëve (Komuna e Lipjanit , Komuna e Shtimes dhe Organizates IKC) , Panairi i planifikuar bujqësor për 12 qershor , është shtyer për datën 6.korrik .2017 për arsye sepse 12 Qershori kësaj radhe perkonte me zgjedhjet qendrore dhe ishte festa e ramazanit ,
- DBPZHR- ka vazhduar me pranimin e kërkesave për përkrahje në serra dhe makina mjelëse.
- DBPZHR-ka formuar komisionin përkatës për dalje në teren.
- Komisioni përkatës i Drejtoratit për bujqësi ka vlerësuar edhe fermer të cilët kanë parashtruar kërkesat e tyre për dalje në vendëshikim, për të janë hartuar procesverbalet e vlerësimeve .
- **Më 16.qershor .2017 Zjarri kishte kapluar fermën e Muhamet Zeqirit nga Babushi i Muhaxherëve në orët e vona të natës , përveç objektit i ka djegur edhe 28 krerë lopë nga 31 sa i kishte brenda në stallë.**

Në vendin e ngjarjes kishin dalë ekipet e zjarrfikësve, policia e Kosovës, ekipet e forncikës si dhe ekipet e KEDS-it si dhe përfaqësues komunal nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë në Lipjan .

Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari në Komunën e Lipjanit, menjëherë me të marr lajmin kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe me stafin e kësaj drejtorie kanë proceduar vlerësimin e dëmeve.

“Sapo kemi marrë informatën jemi shku në vendin e ngjarjes bashkë me stafin profesional dhe kemi filluar përpjekjet për vlerësimin që na takon neve si drejtorat dhe në harmoni me kapacitetet tona buxhetore. Na vije keq që këtij fermeri i ka ndodhur kjo pasi është një nga fermerët potencial të komunës sonë dhe do të bëjmë përpjekje që me kapacitetet që i ka komuna t’i dalim në ndihmë” por adresa për një ndihmë më adekuate është Ministria e Bujqësisë.

Ekipet nga Komuna dhe Ndërmarrja ‘Pastërtia’ kanë filluar largimin e lopëve të ngordhura dhe kanë bërë groposjen e tyre në lokacionin e caktuar.

Ndërsa në sektorin e pylltarisë janë zhvilluar aktivitetet në mbrojtjen e pyjeve nga prerjet dhe zjarret .